



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Tiranë, me 06.02.2019

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit Nr. 11 datë 06.02.2019 “Për pranimin e 2 (dy) punonjësve si personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2018 – 2019, ne Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), që duke filluar nga **data 06.02.2019** deri më **11.02.2019**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

Departamenti i Mjekësisë Sportive

- **Lenda:** “Anatomi dhe Fiziologji Humane”
Moduli: “Fiziologji Humane” (Bachelor) 1(një) As/ Lektor, Lektor

- **Lenda:** “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”
Moduli: “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”
“Aktiviteti Motor sipas Grupeve të veçanta” (Master shkencor) 1(një) Lektor

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shënuar qarte mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomën dhe Certifikatën e notave të studimeve Bachelor (fotokopje)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
- Certifikatën e gradës Doktor i Shkencave (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor (nqs ka) (fotokopje)
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punës për t’u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për modulin “Fiziologji Humane”, të lëndës: “Anatomi dhe Fiziologji Humane” në ciklin e parë të studimeve (Bachelor)

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).

- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve “Bachelor”, me mesatare notash mbi 8 (tetë) (fotokopje) (e detyrueshme)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND me mesatare notash mbi 8 (tetë) (fotokopje) (e detyrueshme).
- Fusha e Studimit dhe Diplomimit duhet të jetë në Shkencat Mjekësore.
- Të ketë përvojë pune të paktën 5 vjeçare në institucionet që ofrojnë kujdes shëndetësor.
- Preferohen pedagogët që kanë përvojë në mësimdhënie në lëndët paraklinike në Institucionet e arsimit të lartë.
- Të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze)

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për modulet: Aktivitet Fizik dhe Shëndeti dhe aktiviteti motor sipas grupeve të veçanta të lëndës Aktivitet Fizik dhe shëndeti për ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor”

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve “Bachelor”, me mesatare notash mbi 8 (tetë) (fotokopje) (e detyrueshme)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND me mesatare notash mbi 8 (tetë) (fotokopje) (e detyrueshme).
- Të jetë së paku “Doktor i Shkencave” në shkencat mjekësore (fotokopje e noterizuar)
- Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar ose Profesor. (nqs ka) (fotokopje e noterizuar)
- Fusha e Studimit dhe Diplomimit duhet të jetë Mjekësi e Përgjithshme.
- Preferohen pedagogët që kanë përvojë në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë.
- Të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze).

Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti ku konkuron, Departamenti, specialiteti, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail të konkurentit.

REKTOR

Prof. Dr. Agron CUKA